

## **Shpallje konkursi, për realizimin e “Logos” për Konferencën Ministrore të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA).**

### **Detyra e projektimit dhe Qëllimi i realizimit**

Qëllimi i realizimit të Logos është organizimi i Konferencës Ministrore të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA).

Konferenca e Ministrave përgjegjës për Arsimin e Lartë, ka për qëllim analizën e rezultateve të zbatimit të Procesit të Bolonjës për periudhën 2000-2024 dhe aprovimin e angazhimit politik për periudhën 2024-2027.

Konferenca që mbledhet në Tiranë 28-29 Maj 2024, është në vijim të konferencës së mbajtur në Romë në 19 Nëntor 2020. Ajo do të ketë logon e saj, që duhet të shpreh mesazhin/idenë themelore të kësaj konference.

Tematika e konferencës është e lidhur me zhvillimet dhe sfidat e arsimit të lartë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë dhe më gjerë. Duhet përmendur që në periudhën ndërmjet dy konferencave, arsimi i lartë si dhe shumë nën sektorë të tjerë, u përballen me sukses me Covid 19, duke marrë përvoja të dobishme për zhvillimin e tij në të ardhmen.

Në kontekstin që jetojmë, arsimi i lartë luan një rol shumë të rëndësishëm në ndërtimin e një shoqërie demokratike, të karakterizuar edhe nga dimensionin social, diversiteti dhe barazia.

Arsimi i lartë ngelet një forcë e rëndësishme për përballimin e sfidave në Zonën Evropiane. Në të njëjtën kohë ai prodhon, ruan dhe transferon vlerat që lidhen me lirinë akademike, integritetin akademik, autonominë institucionale, pjesëmarrjen e studenteve dhe të stafit akademik në drejtimin e arsimit të lartë, përgjegjshmërinë publike, etj.

Pjesë e këtyre vlerave është krijimi i kushteve për rritjen e mobiliteteve të studentëve dhe stafit akademik që lehtësohet/mbështetet nga zbatimi i sistemit me 3 cikle. Këto mobilitete janë pjesë e ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë, që vazhdon të mbetet një drejtim i rëndësishëm i vet procesit Bologna.

Realizimi i misionit të arsimit të lartë do të mbështetet nga zbatimi i standardeve të akreditimit (ESG) duke synuar krijimin e një kulture të cilësisë së arsimit të lartë.

Konferenca do të përhap dhe mbështesë idetë e inovacionit në arsimin e lartë, duke kontribuar në zhvillimin dhe përdorimin e IA.

Logo duhet të shpreh qëllimin për arsim të lartë cilësor, gjithëpërfshirës e kontribuues për demokracinë e zhvillimin e qëndrueshëm në kushtet e zhvillimit industrial e digjital.

### **Tematika kryesore e konferencës:**

Ndërtimi i Urave: Përparimi i Inovacionit, Cilësisë dhe Partneriteteve

**Nën tematikat:**

- Nxitja e një mentaliteti evropian duke inkurajuar bashkëpunimet dhe lëvizshmërinë ndërkombëtare;
- Aftësitë digjitale dhe të gjelbra për fuqinë punëtore evropiane: roli i Inteligjencës Artificiale në përgatitjen për profesionet e të ardhmes/të reja;
- Përdorimi i Inteligjencës Artificiale në Arsim dhe Kërkim Shkencor;
- Nxitja e dialogut në politikën globale për arsimin e lartë (Global Dialog).

**Kriteret dhe udhëzimet që kërkohen:**

- Logo duhet të jetë unike dhe bashkëkohore;
- Të përçojë një mesazh të qartë;
- Të jetë e përdorshme në materialet e promovimit;
- Të shfaqë cilësi të lartë për informacionin që transmeton;
- Të përmbajë gjithashtu, por pa u kufizuar akronimin EHEA dhe “Tiranë 2024”;
- Të krijohen deri 3 variante të logos, nga të cilat Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) do të zgjedh dhe aprovojë finalin.

**Specifikime Teknike të logos:**

- Logoja të jetë me ngjyra;
- Formatet në të cilat duhet të dorëzohet logo: Jpeg; Pdf; Png; Ai; Eps; Tiff;

**Logoja duhet të jetë e aplikueshme edhe në:**

- Dokumente zyrtarë si Komunikata e Ministerialit dhe jo vetëm;
- Materialet e nevojshme të konferencës si: Ftesa; Programi;
- Materialet promovuese për secilin pjesëmarrës, duke përfshirë edhe çantën;
- Materiale informuese elektronike ose në format hard copy;
- Broshura;
- Poster;
- Bill boarde; etj.

**Kush mund të aplikojë?**

- Të gjithë studentët e interesuar të Akademisë së Arteve të Bukura;
- Të gjithë studentët e interesuar të Arkitekturë Interieri dhe Dizajn në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës;
- Studentë të tjerë;
- Pranohet edhe puna e realizuar me grup studentesh.

### **Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs**

- Letër/e-mail për shprehje interesi;
- CV;
- Kartë identiteti (jpg/pdf);
- Të paktën 2 logo të realizuar me parë;
- Të gjithë elementet logos duhet të jenë krijim origjinal;
- Deklaratën për njohjen e mirë të termave të referencës.

### **Vlerësimi i ofertave**

Të gjitha propozimet konkurruese do të vlerësohen nga një juri profesionistësh.

### **Koha e zhvillimit dhe shpalljes së fituesit të konkursit**

Shpallja e Konkursit bëhet më datë **5 Shkurt 2024**.

Data e fundit e aplikimeve është **15 Shkurt 2024**.

Shpallja e fituesit do të bëhet jo më vonë se data **20 Shkurt 2024**.

Shpallja e fituesit bëhet me njoftim në faqen zyrtare të MAS, si dhe në adresën e email-it të aplikantit.

Aplikimi do të realizohet elektronikisht në e-adresën: [erjon.ndroqi@arsimi.gov.al](mailto:erjon.ndroqi@arsimi.gov.al)

### **Deklarim**

Çdo person që paraqet një logo duhet të firmosë një deklaratë që vërteton se logoja e tij/saj nuk shkel të drejtat një pale të tretë dhe nuk dhunon të drejtën e autorësisë së një pale tjetër.

Të gjitha të drejtat që rrjedhin nga pronësia intelektuale i përkasin MAS dhe autori përjashtohet nga çdo përfitim.

Çdo logo e propozuar që merret nga burime të tjera të hapura ose private, si e kopjuar nga projekte të mëparshme përbën shkelje dhe oferta refuzohet. Do të konsiderohen vetëm ato logo që janë punime origjinale.